

Njoftim për përqendrimin me të cilin Rade Konçar TEP SHPKNJP, Shkup synon të fitojë kontroll mbi Rade Konçar aparatna teknika SHA Shkup (lënda nr. 08-134/2025)

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.145/10, 136/11, 41/14, 53/16, 83/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 208/24 dhe 16/25), më datë 11.09.2025, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës është dorëzuar njoftim për përqendrimin me të cilin Rade Konçar TEP SHPKNJP, bul. 3-ta Makedonska brigada nr. 52 Shkup, synon të fitojë kontroll mbi Rade Konçar aparatna teknika SHA Shkup, bul. 3-ta Makedonska brigada nr. pn, Shkup.

Pjesëmarrësit në përqendrim dhe aktivitetet e tyre afariste

Rade Konçar TEP SHPKNJP merret me prodhimin e aparateve për distribuimin dhe kontrollin e energjisë elektrike.

Rade Konçar TEP SHPKNJP është në pronësi të Rade Konçar SHPK Shërbime dhe riparime të produkteve elektrike, veprimtaria e të cilit është riparimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve elektrike.

Rade Konçar aparatna teknika operon si një kompani holding.

Në bazë të hetimit preliminar, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bjerë nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje është i rezervuar.

Komisioni fton palët e treta të interesuara të dorëzojnë vërejtje dhe mendime për këtë përqendrim në Komision. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuara mund të dërgohen në adresën: rr. "Shën Kirili dhe Metodi" nr. 54, Shkup ose me e-mail: kzk@kzk.gov.mk dhe ato duhet të arrijnë në Komision brenda 10 ditësh nga data e publikimit të këtij njoftimi.

10.10.2025

Shkup